



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TE EKONOMISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORË  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS  
NR. 1038 PROT.  
DATA 29.04.2024

Nr. 3 Prot

Datë, 29.04.2024

**VENDIM**

**Nr. 2, datë 29.04.2024**

**PËR  
PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË  
NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E  
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E  
EKONOMISË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË.**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18, pika 3 të Vendimit të Senatit Akademik Nr.11, datë 21.03.2024 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë;

**Komisioni Zgjedhor i Fakultetit:**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përherëshme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve nga data 07.05.2024 deri në datën 13.05.2024, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.
3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim. Pas regjistrimit, kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
4. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë dhe në faqen zyrtare [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë**

**Ilira Pulaj**

**Anëtarët**

**Klaudja Guga**

**Fjoralba Latifaj**

**Sekretare  
Dorjana Feimi**



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË EKONOMISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVES  
NR. 1038/1  
DATA 29.04.2024

Nr. 3/1 Prot

Datë, 29.04.2024

## NJOFTIM

### **PËR KRITERET E REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E EKONOMISË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Senatit Akademik Nr.11, datë 21.03.2024 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, neni 25, Vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë Nr. 2, datë 29.04.2024 "Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë",

Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati në Fakultetin e Ekonomisë, kati i dytë, godina A, salla A 203.

#### **I - Kandidatët për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe Drejtues të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

a).Kërkesa për kandidim, përmban:

- 1.Emrin;
- 2.Atësinë;
- 3.Mbiemrin;
- 4.Datëlindjen;
- 5.Gjininë;
- 6.Kopje të dokumentit të identifikimit;
- 7.Shprehjen e vullnetit për kandidim;
- 8.Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
- 9.Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
- 10.Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
- 11.Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- 12.Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
- 13.Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË EKONOMISË

**II - Kandidatët për Anëtar të Komisioneve të Përhershme duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

a). Kërkesa për kandidim, përmban:

1. Emrin;
2. Atësinë;
3. Mbiemrin;
4. Datëlindjen;
5. Gjininë;
6. Kopje të dokumentit të identifikimit;
7. Shprehjen e vullnetit për kandidim;
8. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
9. Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
10. Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
11. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
12. Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

**III - Kandidatët për Anëtar të Komisioneve të Përhershme në Njësinë Kryesore nga radhët e studentëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:**

1. Kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
2. Kopje të dokumentit të identifikimit;
3. Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në Fakultetin e Ekonomisë;
4. Propozimin nga jo më pak se 30 (tridhjetë) studentë, pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në Rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit, vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit.
5. Dokumentin që vërteton mesataren e notës mbi bazën e provimeve të dhëna deri në momentin e kandidimit.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Ekonomisë**

**Ilira Pulaj**

**Anëtarët**  
**Klaudja Guga**  
**Fjoralba Latifaj**

**Sekretare**  
**Dorjana Feimi**